



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-1935/21 datë: 20.01.2021



Npi – 01/28 datë: 25.01.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 25.01.2021 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 25.01.2021 (e hënë) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbrësja Sylja, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtoresha e DPUKGJ-së znj.Shqipe Rexhaj, Znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet më 20.11.2020 dhe 18.12.2020,
2. Propozim-Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020,
3. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Raçak,
4. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petrovë,
5. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Shtime,
6. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petroviç (Lagja e Pajtimit),
7. Rishqyrtimi i Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2021 sipas rekomandimit të MPL-së,
8. Draft-Rregullore komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021(pas diskutimit publik),
9. Draft-Plani lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025 (pas diskutimit publik),
10. Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes (pas diskutimit publik),

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës, Kryesuesja e njoftoi Komitetin se Ekstrakt Procesverbali nga mbledhja më 20.11.2020, nuk është gati kështu që duhet të largohet nga rendi i ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës, pa Ekstrakt Procesverbalin e KPF-së nga mbledhja e mbajtur më 20.11.2020.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 18.12.2020

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 18.12.2020.**

Pika 2

Propozim-Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Lexoi materialin për këtë pikë, dhe në vazhdim hapi diskutimin.

z. Perparim Ramusa; Përshëndetje, për këtë pikë kemi diskutuar mjaft shumë dhe kemi ardhur në një pikë ku nuk mund të shkojmë më tutje. Kështu që unë propozoj që ti rekomandojmë Kuvendit aprovimin e kësaj pike.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për”, me 0 vota “Kundër dhe me 1 votë “Abstënim”, vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovimin e vendimit për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020.**

Pika 3

Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Raçak

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Shqipe Rexhaj.

znj. Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Përshëndetje, siç e dini këtu po bëhet fjalë për rrugën “15 Janari” Shtime-Reçak, e cila qon deri te Kompleksi i varrezave të Masakrës së Reçakut. Këtu janë përfshi të gjitha pronat në këtë rrugë të cilat duhet të shpronësohen për shkak të marrjes së pronave me qëllim të zgjerimit të kësaj rruge.

z. Perparim Ramusa; Sçarimet që i dha drejtoresha po len të nënkuptohet se jemi para një akti të kryer. Prandaj unë mendoj se neve na mbetet vetëm që ta zbatojmë Ligjin dhe ta aprovojmë, sepse pronat janë marrë për zgjerimin e rrugës, deri te Kompleksi memorial i Masakrës së Reçakut.

z. Naim Zejna; Edhe unë jamë “Për” por rruga ka përfunduar qysh në vitin 2009, pse tani po merremi me këtë çështje. A është në pyetje se është rritur numri i kërkesave për shpronësim, apo është iniciativë e juaja?

znj. Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Sçaroi këtë pyetje.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale – Raçak.**

Pika 4

Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale – Petrovë

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Shqipe Rexhaj.

znj. Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Kjo ka rrjedhë si rezultat i një kërkesë të palës Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, dhe këtu po bëhet fjalë për një pronë ku ka qenë rrugë e mëhershme në fshatin petrovë.

znj. Zarife Rexhaj; A ka ndonjë vlerësim, se mos ka ndonjë kërkesë ose ankesë nga banorët aty?

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Ne tani te kjo kërkesë jemi kthyer në pikën zero, sepse pala ka kërkuar në kërkesën e tij që të shtohet edhe një ngastër aty ngjitur me te.

z.Naim Zejna; Pyetja ime është a e ka përfunduar ai kërkesën e tijë në Gjykatë? Dhe tjetra a ka ndonjë pëlqim të Komunës me palën Bahri Rexhaj?

z.Perparim Ramusa; Ne te ky rast e kemi marrë një vendim, Tash neve na duhet që sipas Ligjit me e shpallë me interes të përgjithshëm.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për”, me 0 vota “Kundër dhe me 1 votë “Abstenim”, vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale – Petrovë.**

Pika 5

Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Shtime

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Shqipe Rexhaj.

znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Sqaroi se te kjo kërkesë kemi edhe pronarë të komunitetit Serb, e që realisht te ky propozim-vendim kemi të bëjmë me shpalljen e disa pjesëve të ngastrave te sheshi “Ahmet Shtimja”. Te ky rast kemi folë me banorët dhe janë pajtuar, tani presim që të aprovohet në Kuvend.

znj.Zarife Rexhaj; Sa u përket pjestarëve të komunitetit Serb, a keni pas kontakt me ta?

znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Unë thash se mjetet financiare mbeten në llogarinë e Komunës, deri sa të merremi vesh me pronarët legjitim të parcelave.

z.Perparim Ramusa; Unë bëj apel te kolegët që këto prona të shpronësohen sepse është me interes të përgjithshëm. Pra ti rekomandojmë Kuvendit aprovimin e kësaj pike.

z.Naim Zejna; Unë do të “abstenoj” sepse nuk e njoh mirë këtë problem. Mendoj se në disa vende nuk do të duhej të ketë pronë individuale, por kur ta marr manualin do ta shoh se si është gjendja e pronave.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për”, me 0 vota “Kundër dhe me 2 vota “Abstenim”, vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale – Shtime.**

Pika 6

Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petroviç (Lagja e Pajtimit)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Shqipe Rexhaj.

znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Te ky propozim –vendim po bëhet fjalë për dy rrugë. Njëra është te shkolla “Emin Duraku” dhe tjetra te rruga “Tranzit”.

z.Naim Zejna; Nuk kemi informacion se kurë është ndërtuar rruga, si dhe kush janë pronarët e parcelave. Unë po e rezervoj të drejtën që në Kuvend ti diskutojmë mirë, dhe në mbledhje të na e sillni materialin e mjaftueshëm.

z.Perparim Ramusa; Unë propozoj që këtë pikë ta shtyejmë deri në mbledhjen e muajit Shkurt, me qëllim që ta kemi informacione shtesë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për”, me 1 votë “Kundër dhe me 0 vota “Abstenim”, vendosi t’i rekomandoj Kuvendit shtyrjen e Propozim-Vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petroviç (Lagja e Pajtimit), deri në mbledhjen e muajit Shkurt, me arsyetimin që të marrim më shumë informata për këtë pikë.**

Pika 7

Rishqyrtimi i Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2021 sipas rekomandimit të MPL-së

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj. Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Përshëndetje, ne kemi udhëzim nga Ministria që Rregulloren e Tatimit në Pronë për vitin 2021, me e anuluar, konform nenit 9 të Ligjit për Tatimin në Pronë Nr.06/L-005. Dhe për vitin 2021 nevojitet të aprovohet vendimi për Normat Tatimore, të cilin ne e kemi propozuar dhe që e keni marrë me kohë. Normat tatimore që i kemi propozuar ne me këtë propozim-vendim janë normat më të ulta të mundshme, kështu që nuk kemi mundësi të diskutojmë për uljen e tyre.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit:

1. **Anulimin e Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021, Npi-01/267 të dates: 24.11.2020.**
2. **Aprovimin e vendimit për Normat Tatimore të Komunës së Shtimes për vitin 2021.**

Pika 8

Draft-Rregullore komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021 (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj. Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Bazuar në Vendimin e Kuvendit, Npi – 01/306 Datë: 22.12.2020, për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021, për afatin prej 15 ditësh, ne kemi organizuar debatin On-line për shkak të pandemisë Kovid19, mirëpo mund të them se nuk ka ndonjë propozim konkret i cili duhet të inkorporohet në propozim-vendim. Prandaj unë ju ftoj që ta aprovoni kështu siç është propozuar.

z. Naim Zejna; Unë kam thënë që Rregullorja duhet të vie për aprovim para buxhetit, dhe po ashtu kërkoj që të shiqohet mundësia e zvoglimit të taksave për shkak të pandemisë Kovid 19. Ose në formë uniforme me i zvogluar për 16 %.

z. Perparim Ramusa; Mirë është me i zvogluar por edhe buxheti na nevojitet me qenë më i madh, prandaj unë propozoj që me u aprovuar ashtu siç është.

znj. Adelina Beqaj; Edhe unë jam për me i zvogluar pak taksat, për shkak të pandemisë.

znj. Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Te administrata nuk e di se a ka mundësi për me u zvogluar apo jo, ndërsa të tjerat janë propozuar sipas Udhëzimit Administrativ.

z. Perparim Ramusa; QKMF-ë sot i kryen 25 vizita shtëpiake, dhe këto janë shpenzime për buxhet për me pas mundësinë me funksionuar.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për", me 0 vota "Kundër dhe me 1 votë "Abstenim", vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Draft-Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021.**

Pika 9

Draft-Plani lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025 (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Hamëz Tërshani.

z. Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit prezantoi këtë pikë. Bazuar në Vendimin e Kuvendit, Npi – 01/308 të datës: 22.12.2020, për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Planin Lokal të Veprimit për Mjedis 2021-2025 për komunën e Shtimes, për afatin prej 15 ditësh, ne kemi organizuar debatin publik On-line për shkak të pandemisë Kovid19. Ne jemi interesuar që të marrim fidebec, kemi marrë disa propozime mirëpo jo të rëndësishme për ti inkorporuar në dokument. Prandaj unë ju ftoj që ta aprovoni, dhe nëse ka ndonjë pyetje, jam këtu për tu përgjigjur.

znj. Zarife Rexhaj; Unë më heret e kam pas si propozim që Stacioni Policor i vjetër të shëndërrohet në Muze, dhe ky propozim ka pas përkrahje të madhe. Ai objekt mundet me u rrënuar për gjysëm ore dhe

shkon bashk me te edhe një pjesë e historisë të njerëzve të persekutuar në këtë stacion policor që ka ndodhur para lufte nga forcat serbe. Unë nuk e di tani saktësisht se a duhet që edhe ky objekt të përfshihet në këtë dokument, prandaj ju lus që të na jepni sçarime për këtë?

z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Jo nuk përfshihet në këtë dokument.

z.Naim Zejna; Unë e kam pa që ka qenë një ekip i mirë, që ka punuar në këtë dokument, mirëpo mundësia për të bërë ndërhyrje ka qenë e shkurtë. Propozoj që për hera të tjera të merret parasysh gjithqysh që të përfshihet edhe Kuvendi.

znj.Zarife Rexhaj; Kam edhe një pyetje tjetër, sa është paraparë në dokument mirëmbajtja dhe menaxhimi i mbeturinave? Sepse unë e di që ka familje që nuk kanë fare kontejner.

z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Në dokument e kemi të paraparë pikën për efektet e ndikimit në ambient, qe dy vjet më parë. Sigurisht që PLV-ë jep një pasqyrë të përgjithëshme, mjedisore kështu që nevojitet që të gjithë të punojmë në harmoni me këtë dokument, pasi të aprovohet.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Draft-Planit Lokal të Veprimit për Mjedis 2021-2025 për Komunën e Shtimes.**

Pika 10

Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Shala.

z.Benik Shala, zyrtar i personelit; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit prezantoi këtë pikë. Ne e kemi përgatitur për Kuvend këtë Draft-Kodin e etikës për komunën e Shtimes, i cili është i bazuar në draftin e Departamentit për Shërbyesit Civilë, dhe kemi vërejtë që është një draft mjaft i mirë. Bazuar në Vendimin e Kuvendit, Npi – 01/307 të datës: 22.12.2020, për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes, për afatin prej 15 ditësh, ne e kemi organizuar debatin publik, por nuk ka pas aq shumë të interesuar, dhe nuk ka pas ndonjë propozim konkret i cili mund të inkorporohet në dokument. Në hartimin e dokumentit kanë qenë të përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit, kështu që unë ju ftoj ta aprovon, dhe nëse ka ndonjë pyetje, jam këtu për tu përgjigjur.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoi Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Unë kamë qenë anëtarë i Komisionit, është bërë një punë dhe një draft mjaft i mirë, që ka nevojë ta ketë Komuna. Ky dokument i ri u mungon shumë komunave tjera, prandaj unë konsideroj se është mirë që ta përkrahim.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Draft-Kodit Etik të Komunës së Shtimes.**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi ne ora 11.08h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

